



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXIII-të (njëzetetre - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 05 korrik 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkollli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Driton Shabani nga Stacioni i Policisë në Podujevë; Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE, Tamas Pap përfaqësues i KFOR.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj punë të mbarë, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj në vazhdim po i lexoj rendin e ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 9 vota Për, nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Informatë për organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM)

Thirrja publike për projekt propozime për biznese të vogla për stabilizimin e Komuniteteve jo shumicë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, për bashkëpunim shumë të mirë që kem me këtë Organizatë duhet të falënderohet edhe shefi i ZKKK në Podujevës z.Liman Zeqiri i cili vazhdimisht ka qenë i përkushtuar në sjelljen e projekteve nga kjo Organizatë për komunitetin jo shumicë në Komunën e Podujevës ngase të gjitha donacionet kanë shkuar përmes zotëri Zeqirit i cili sërish e potencoj se ka qenë shumë i interesuar dhe përkushtuar në përfitimin e projekteve.

Me IOM ne kemi bashkëpunim qe një kohë të gjatë dhe falë kësaj Organizate si komunitet jo shumicë në Komunën e Podujevës kemi qenë përfitues të shumë projekteve të ndryshme e që falë atyre donacioneve edhe sot ka perona të ndryshëm të komunitetit jo shumicë që punojnë me ato mjete duke siguruar mbajtjen e familjes, krijimit të të ardhurave dhe ngritjen e punësimit, prandaj e kemi parë të arsyeshme që ta përfshijmë në rend të ditës këtë temë duke informuar Komitetin për Komunitete në lidhje me bashkëpunimin me këtë Organizatë si dhe të diskutojmë lidhur me Thirrjen publike për projekt propozime për biznese të vogla për stabilizimin e

komuniteteve jo shumicë, që e ka hapur kjo Organizatë ngase është një mundësi e mirë për të përfituar komuniteti jo shumicë në projekte të ndryshme që ka paraparë IOM.

Njëkohësisht ftoj anëtarët e këtij Komiteti me theks anëtarët e Komunitetit jo shumicë që t'i informojnë komunitetin jo shumicë në lagjet apo rrugët ku jetojnë ata lidhur me këtë thirrje për përfitim në donacionet e IOM sepse kjo thirrje ka qenë deri më 01.07.2024 por që është shtyrë afati i aplikimit deri më 15.07.2024 për shkak të mos aplikimit të numrit të mjaftueshëm për përfitim në projektet e IOM.

Vlen të theksohet se me ndihmën e z.Liman Zeqirit unë e kam marrë dokumentin e aplikimit dhe ju kam shpërndarë të gjithë komunitetit jo shumicë, dokument në të cilin janë të gjitha sqarimet e nevojshme për aplikim në këto projekte, prandaj mund të them se komuniteti jo shumicë është i informuar rreth kësaj çështje sepse çdo familjeje i është shpërndarë nga një dokument i tillë i konkursit, mirëpo nuk kam informata deri më sot sa prej tyre kanë arritur të aplikojnë në këto projekte edhe pse mund të them se fillimisht ka qenë një dilemë rreth aplikimit sepse disa nuk kanë qenë në gjendje të aplikojnë mirëpo meqë në atë dokument ka qenë edhe numri kontaktues i telefonit kanë kontaktuar dhe janë informuar në detaje se si ta plotësojnë aplikimin, kështu që ditëve të fundit kam vërejtur se është stabilizuar gjendje sepse nuk kam as unë më thirrje telefonike rreth kësaj çështje.

Për këtë fjalën i'a jap edhe z.Liman Zeqirit - shef i ZKKK-së në Komunën e Podujevës me qëllim të na informoj edhe ky lidhur me bashkëpunimin dhe projektin përkatës me IOM.

z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK në Komunën e Podujevës, theksoi, në fakt edhe Kryesuesi i këtij Komiteti përmendi paraprakisht çështjet kryesore dhe të rëndësishme lidhur me bashkëpunimin me IOM e që Komuna e Podujevës ka rreth 15-16 vite që ka bashkëpunim të ngushtë dhe tani së fundmi kemi një Memorandum të Mirëkuptimit të nënshkruar mes Organizatës IOM dhe Kryetarit të Komunës të cilin duhet falënderuar për angazhimin dhe hapjen e mundësive për bashkëpunim me këtë Organizatë e cila bën menaxhimin dhe implementimin e projekteve të cilat ndahen dhe financohen nga Bashkimi European / Zyra e BE-së.

Duke falënderuar këtë Organizatë dhe falë bashkëpunimit tonë korrekt, të gjitha shkollat ku vijojnë mësimin edhe nxënës të komunitetet jo shumicë kanë qenë përfituese të projekteve të ndryshme e që ato projekte pastaj janë në interes të të gjithë nxënësve pa dallime, pra janë pajisë me të gjitha kabinetet të cilat ata e kanë parë të arsyeshme dhe për këtë duhet të falënderohet edhe drejtori i DKA-së në Komunën e Podujevës si dhe drejtorët e shkollave për bashkëpunim të ndërsjellë.

Normale se në këto projektet përfituese të Komunës është edhe shuma prej 30% e projektit e cila duhet paguar nga Komuna kurse 70% financim i donatorit të investimeve që kanë qenë në shkolla të ndryshme siç janë në Podujevë “DR Ibrahim Rugova” , “Shaban Shala” , “Naim Frashëri” , pastaj shkolla “Luigj Gurakuqi” në fshatin Batllavë, “Ali Ajeti” në fshatin Sfeçël, “Zahir Pajaziti” në fshatin Orllan, pra kanë qenë përfituese të projekteve të IOM të gjitha shkollat ku vijojnë mësimet nxënës të Komuniteteve jo shumicë ku janë pajisur me kabinate më moderne dhe bashkëkohore të cilat janë shumë të nevojshme për proceset mësimore e që ndikojnë tek të gjithë nxënësit pa përjashtim.

Po ashtu kjo Organizatë merret edhe me stabilizimin socio-ekonomik të komuniteteve jo shumicë, andaj edhe kjo Thirrje publike për të cilën po diskutojmë e ka këtë tretman andaj edhe kërkohet të konkurrojnë të gjithë të interesuarit nga komunitetet jo shumicë sepse afati tani është shtyrë deri më 15.07.2024 e që mund të jenë përfitues ata të cilët kanë ide për biznese të vogla, rritje dhe zhvillim të bizneseve ekzistuese, pra përfitimet janë me mjete financiare dhe mjete

pune e që janë fitimprurëse ku jo shumë larg kanë qenë me dhjetëra projekte tjera përfituese të cilat i kemi shpërndarë të cilat edhe kanë pas sukses si projekte e që sigurisht që IOM duke parë se sukcesi është në rritje kanë shpreh mendimin e tyre dhe kanë vlerësuar që sërish të shpallin thirrje për aplikim në projekte të ndryshme për financimin e projekteve si ndihmë për Komunitetin dhe për Komunitetin jo shumicë të cilët kanë aftësi dhe dëshirojnë të jenë përfitues të projekteve qoftë duke hapë biznese qoftë në ngritjen e bizneseve ekzistuese që kanë.

Tani konkurrimi është online dhe jo i komplikuar siç ka qenë paksa në të kaluarën, por në formular është numri i telefonit ku secili mund të konstatoj dhe të merr instruksione se si të aplikoj ku sigurisht se gjejnë mbështetje teknike sa i përket aplikimit, andaj bëjë thirrje që të konkurrojnë sa më shumë qytetar të komuniteteve jo shumicë ngase numri i përfituesve këtë herë do të jetë në rritje.

Pra kjo është ajo që neve na bënë kureshtje për t'i ndihmuar njerëzit në mënyrë që të mos mbeten parazitë nëse mund të them kështu.

Po ashtu duhet të informoheni se nga Ministria përkatëse ka qenë një kriter i cili vazhdimisht ka ndikuar në aspektin ekonomik tek të gjitha familjet e veçmas te familjet e komuniteteve jo shumicë, pra kriteri i fëmijës 5 vjeçar që është, por tani kanë mbetur vetës si kriter gjendja e rëndë ekonomike, i papunë, gjendja jo e mirë shëndetësorë me të vetmin qëllim që të krijohen mundësi dhe forma të hapjes dhe bizneseve dhe arritjes së punësimit dhe vetëpunësimit njëkohësisht.

Pra kriterin që ata persona që janë në asistencë sociale nuk mund të jenë përfitues, jua kam shpjeguar shumicës së familjeve të Komuniteteve jo shumicë, ngase pastaj nëse përfitojnë do t'ju ndalet asistencë sociale, prandaj kjo është ajo që gradualisht në të ardhmen duhet ardhur deri te punësimi për çka ne kemi edhe Planin e Veprimit për avancimin e të drejtave të komunitetit jo shumicë, në të cilin përfshihet edhe fusha e punësimit e që punësimi është një mundësi shumë e madhe dhe primare e që tek ne ka qenë ajo pika kulmore ta quaj kështu siç kanë qenë shëndetësia, arsimit, strehimi, infrastruktura si dhe fushat tjera që kanë qenë sfidë për vendin vazhdimisht e që secila prej tyre ka një etapë të vetën në kohë mirëpo punësimi mendoj se është më i theksuar.

Tani së fundmi jemi në dijeni se nën autoritetin e Kryetarit të Komunës janë punësuar edhe një numër i pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Pastrimi" të cilëve i'u është vazhduar punësimi edhe për 1 vit gjithnjë në bashkëpunim edhe me shefin rajonal të kësaj Kompanie ku paga e atyre të punësuarve bëhet 50% nga Komuna dhe 50% nga Kompania, andaj kjo është ajo intenca jonë qoftë si institucione për ndihmë komuniteteve dhe të konkurrojnë nëpër projekte të tilla në mënyrë që të arrijnë të jenë përfitues e që do të ishte interes edhe i joni si Komunë që jemi shumë të interesuar në funksion të stabilizimit socio-ekonomik të komuniteteve jo shumicë por që normale se është edhe interes edhe i atyre qoftë familjar qoftë individual që të jenë përfitues të donacioneve dhe të hapin mundësi për biznes dhe punësim, e ka të tillë që nga donacione e përfituara më parë janë zhvilluar dhe kanë rritë biznesin e tyre siç është zotëri Turreci i cili ka përfituar dy projekte dhe është funksional ngase për tri vite jemi të obliguar të përcjellim se a po funksionon si biznes apo jo por që normale se IOM dhe BE kurdo që vërejnë se dikush ka motiv për të punuar dhe për tu zhvilluar si biznes i japin edhe motiv dhe donacione tjera për t'u rritë si biznes, pra i japin edhe projekte shtesë dhe jo vetëm një herë por më shumë ngase ai person e ka rritë biznesin e vetë, prandaj kjo është njëra ndër arsye për t'i stimuluar të tjerët që të konkurrojnë dhe të përfitojnë në mënyrë që të bëhen të pavarur në sigurimin e jetës për vete dhe familjen si dhe pse jo edhe rritjen e numrit të të punësuarve.

Gjithashtu në bazë të kontakteve që kemi me menaxherin e IOM ata janë falënderues edhe ndaj Komunës që çdo herë ka kryer me kohë dhe pa vonesa obligimet financiare të 30% të projektit e që këtu duhet falënderuar edhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili ka qenë shumë efikas, çështje kjo e cila ka bërë kureshtje tek ajo Organizatë duke u bërë Komuna e Podujevës shembull për Komunitet tjera.

znj. Sevdije Mustafa, theksoi, kam një pyetje rreth këtij projekti, a është numri i caktuar i përfituesve në Komunën e Podujevës apo si qëndron çështja se sa mund të jenë përfitues i peronave të Komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës nga projekti bashkë financues i BE përmes IOM.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, duke i'u përgjigjur parafolëses theksoi, jo numri nuk është i caktuar se mund të përfitojnë nga kjo thirrje, mirëpo normale se gjithherë ka një komision i cili verifikon dhe përzgjedh përfituesit, andaj ata e përcaktojnë se cili projekt mund të jetë më i rëndësishëm për aplikuesit nëse veç i plotësojnë kushtet dhe kriteret e aplikimit.

Pra në bazë të kontakteve që kam pasë me përqafuesit e Organizatës më është thënë se nuk ka numër të kufizuar të atyre që mund të përfitojnë por është shumë e rëndësishme që sa më shumë të jetë e mundur të aplikojnë në këtë thirrje në mënyrë që numri i përfituesve të jetë më i madh ngase në bazë të informatave që kemi në Komunitet tjera numri i aplikuesve është shumë më i madh, prandaj sërish bëjë thirrje që numri i aplikuesve të jetë sa më i madh se njëkohësisht të zgjedhet biznesi adekuat që mund të kryhet nga personi që mund të jetë përfitues dhe që mund të vie më lehtë deri të përfitimi i donacionit.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, parafolësi z.Liman Zeqiri shumë mirë e elaboroj dhe sqaroj këtë çështje për çka e falënderoj shumë, mirëpo unë vetëm deshta të cekë edhe një gjë se zotëri Turreci nga fshati Sfeçël i cili ka qenë përfitues i donacioneve të tilla, i cili në të kaluarën ka punuar punë mjaftë të thjeshta siç është rregullimi i sëpatave e të ngjashme vetëm që të mund t'ia del të jetoj me familje, mirëpo tani pas marrjes së donacionit nga kjo Organizatë mund të them se është një ndër punëtorët më të mirë të rregullimit të dyerve, rrethojave të tarracave e dhe punë të tjera të hekurit, pra ka qenë përfitues i mjeteve më moderne nga kjo Organizatë e që i është mundësuar të zhvilloj këtë biznes i cili është shumë përfitues në aspektin e të hyrave materiale, veçmas për komunitetin jo shumicë, pra ai person tani punën shumë dhe atë jo vetëm për vete por kur është koha për Komunitetin jo shumicë punët i kryen edhe falas, me një fjalë ai peron është për çdo lëvdatë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, vërtetë qëndron ajo që Kryesuesi i Komitetit e potencoj për zotëri Turrecin nga fshati i Sfeçël i cili ka qenë përfitues i donacionit nga BE / IOM.

Kjo Organizatë parasheh në disa raste që përfituesit e projektit brenda periudhës 3 vjeçare të ndihmojnë dikë falas me shërbime apo forma tjera ta zëm deri në një vlerë 200€ e që ajo duhet pastaj të argumentohet me dokument për ndihmën e dhënë dhe në këtë aspekt kur kemi dal në terren dhe kemi vizituar atë peron t'ju them sinqerisht se unë për vete jam fascinuar dhe kam mbete pa koment nga përgjigja e tij kur i është bërë pyetja në fjalë rreth ndihmës, por që pastaj ai peron ka qenë përfitues edhe i projektit të dytë.

Pra ai peron kishte shumë raste që ka ndihmuar, por ajo që ishte paksa më interesante ishte dokumenti i prezantuar ku kishte ndihmuar Komunitetin shumicë me 3800€ vlerë ku kishte salduar falas gjithë rrethojën e Xhamisë së fshatit Sfeçël, prandaj kemi konsideruar si një prej shembujve më të mirë që t'ju ndihmohet edhe të tjerëve nga biznesi i hapur falë mundësive të donacioneve.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe njëherë falënderoj z.Liman Zeqirin për informatat dhe sqarimet e dhëna. Urdhëroni nepse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike, nëse jo e konsiderojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të të ditës dhe kalojmë në pikën e radhës, por si përfundim nga kjo pikë ishte thirrja dhe apeli ynë për gjithë Komunitetin jo shumicë në Komunën e Podujevës që sa më shumë të jetë e mundur të aplikojnë në thirrjen e BE / IOM në mënyrë që sa më shumë persona të jenë përfitues nga donacionet në fjalë.

2. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, dëshiroj të falënderoj Kryetarin e Komunës tonë i cili nga 5 shtëpitë që do të ndërtohen për familjet në nevojë në bashkëpunim me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” të z.Halil Kastratit ku 1 shtëpi kanë vendosur që t’ia ndërtojnë një familje të Komunitetit jo shumicë e cila vërtetë i kushte e rënda qoftë ekonomike qoftë të banimit.

Fjala është për z.Veli Halilin i cili është kthyer nga diaspora që një kohë të gjatë dhe ka banuar me qira ku ka pasë mundësi dhe ku ka mundur, i njëjti ka blerë një pronë në fshatin Dumnicë, kështu që mirë shumë që është përzgjedhur që tani t’i ndërtohet një shtëpi e që vërtetë ka pasë nevojë të madhe për një ndihmë të tillë ngase edhe për faktin se është numër i madh i anëtarëve të familjes, prandaj edhe njëherë shfrytëzoj rastin të falënderoj edhe Kryetarin e Komunës por edhe z.Halil Kastratin që është bërë e mundur të hyn në listën e përfituesve të ndërtimit të shtëpisë për këtë familje.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konsideroj të përfunduar këtë mbledhje.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0043477/24
Podujevë, 05 korrik 2024**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**